

**KONTRATË THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**“SSulçe” Sh.P.K.**

Sot me datë 02.01.2020, në Gjashtë-Sarandë, me vullnetin tim të lirë, unë i nënshkruari:

- Shkëlqim Hasani, i biri i Sulo, i datëlindjes 04 Mars 1970, lindur në Sarandë dhe banues në Gjashtë-Sarandë, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal H00304106V me datë lëshimi 10/08/2009

ne zbatim te Ligjit 9901, date 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, dhe ligjit nr.9723 date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit” ,

**Neni 1**

Vendosa te themeloj shoqerine me pergjegjesi te kufizuar “SSulçe” shpk.

**Neni 2**

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

- Gërmime, nivelime dhe punime me mjete
- Transport i materialeve inerte dhe të tjera
- Tregëti e mallrave të ndryshme
- Import-Export
- Riparim i mjeteve të rënda

**Neni 3**

Ortakt themelues të shoqërisë është: z. Shkëlqim Hasani.

**Neni 4**

Kjo shoqëri mund te ndryshoje emërtimin e saj, vendqëndrimin, objektin e aktivitetit, te shtoje ortake, te rrisë ose zvogëlojë kapitalin sipas vendimeve te organeve drejtuese te kësaj shoqërie.

**Neni 5**

Kapitali themeltar i shoqërisë është në vlerën e 10,000 lekë (dhjetëmijë) dhe përbëhet nga 1 (një) kuotë, e ndarë si më poshtë:

1. Shkëlqim Hasani, kontribuon me 1 (një) kuotë prej 10,000 (dhjetë mijë) lekë, ose 100% të kapitalit themeltar

**Neni 6**

Selia e shoqërisë është Lagja Gjashtë, Rruga “Skënderbeu” Nr.42, Sarandë.

### **Neni 7**

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë është e pakufizuar në kohë dhe fillon që nga momenti i regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

### **Neni 8**

Administrator i shoqërisë është z. Shkëlqim Hasani, i cili do të qëndrojë në këtë detyrë për 5 vite, me të drejtë rizgjedhje dhe është i ngarkuar të kryejë akte dhe të marrë angazhime që janë në përputhje me objektin e veprimtarisë së shoqërisë.

### **Neni 9**

Personaliteti juridik i shoqërisë fitohet me regjistrimin e saj në regjistrin tregëtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Aktiviteti i saj do të fillojë pas kryerjes së procedurave ligjore. Në aktivitetin e shoqërisë do të përmbahemi statutit të hartuar për këtë qëllim dhe do të respektoj legjislacionin në fuqi. Kjo kontratë themelimi u redaktua në katër kopje, me vlerë të njejtë ligjore, një kopje dorëzohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, një kopje dorëzohet pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Sarandë dhe nga një kopje ortakëve themelues të shoqërisë.

### ***ORTAKËT E SHOQËRISË "SSulçe" SH.P.K.***

Shkëlqim HASANI  \_\_\_\_\_.